

# Leksiku i huaj në prozën e Ernest Koliqit

Haki Hysenaj

20 shtator 2011

## Përmbledhje

Objekt i këtij punimi është studimi i leksikut të huaj në veprën letrare të shkrimtarit **Ernest Koliqit**. Fjalësi me prejardhje të huaj në prozën e këtij autori është hulumtuar në novelat: "*Hija e maleve*", "*Tregtar famujsh*", "*Pasqyrat e Narçizit*" dhe në romanin "*Shija e bukës së mbrumë*". Hulumtimi ka vënë në pah se shkrimtari i përmasave të mëdha, Koliqi, i anatemuar për disa dhjetëvjetësh, në veprën e tij ka përdorur mjaft fjalë të huaja. Materiali i vjelë dhe krahasimi i tij me vepra autorësh të tjerë të kohës së tij e shquajnë Koliqin të veçantë edhe në fushë të gjuhës. Ai nuk identifikohet si purist, por tregohet shumë i kujdesshëm në përdorimin e materies gjuhësore për ndërtimin e tekstit të tij letrar. Numerikisht dhe me denduri më të madhe përdorimi në prozën e tij dalin fjalët me origjinë orientale.

Koliqi, ndonëse nuk ishte gjuhëtar, kishte ndjenjë gjuhësore shumë të zhvilluar. Prandaj, njëjtë siç identifikohet nismëtar i prozës moderne shqipe, bazuar në këtë aftësi, ai mund të identifikohet pa fije dyshimi edhe si shkrimtar që gjuhën e përdori me të gjitha trajtat, me të gjitha variatetet dhe me të gjitha leksemat e nevojshme, madje edhe me prejardhje të huaj, për ndërtim teksti, në radhë të parë të atij narrativ, gjë që nuk kishte ndodhur nga pararendësit e tij rilindës e as nga brezi i shkrimtarëve të kohës së tij. Kështu, Koliqi del shumë i veçantë në letrat shqipe edhe në aspektin gjuhësor. Sa i veçantë në letërsi, po aq i veçantë del edhe në përdorimin e gjuhës.

## 1 Huazimet si burim përftesash stilistike

Pos fjalëve të brumit shqip në gjuhën e veprës së **Ernest Koliqit** takohen fjalë të ndryshme me prejardhje joshqipe. Ato janë huazime nga periudha të ndryshme të kontakteve të shqipes me gjuhë të tjera ose huazime të hyra në shqipe përmes një gjuhe të tretë. Përcaktimi i kohës së depërtimit të fjalëve të huaja në shqipe është punë e leksikologjisë. Vetë cilësimi i një fjale si huazim është një qëndrim etimologjik<sup>1</sup>, ndërsa hulumtimi i rrugëve të depërtimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përmes gjuhës ndërmjetësuese është më shumë çështje e teorive për gjuhët në kontakt<sup>2</sup>.

Huazimet leksikore në gjuhën e veprës së Koliqit më shumë janë vështruar sipas llojit dhe vlerës së tyre përdoruese. Kjo shtresë leksikore, ashtu si shtresat e tjera, i nënshtrohet

<sup>1</sup>Lloshi, 1999: 111.

<sup>2</sup>Shih: Filipovic, 1986:19- 32.

kështu një vlerësimi shoqëror e kulturor, prej të cilit mbeten ngjyrimet stilistike në leksik dhe, rrjedhimisht, mund të shfrytëzohen po për ato synime dhe me po ato përftesa shprehëse<sup>3</sup>. Në këtë plan Koliqi është i përkryer.

Koliqi në gjuhën e veprës së tij leksikon me prejardhje të huaj, posaçërisht atë orientale, gjuhësisht e shfrytëzon për përftesa shprehëse. Përmes tyre bën tipizimin e karaktereve, si dhe përshkrimin e situacionit në të cilin zhvillohet fabula e rrëfimit. Ndërsa, në përdorimin stilistik, Koliqi provon suksesshëm atributin evokues të këtij shtresimi për personazhe dhe ambiente të caktuara. Shumica e huazime që dalin në veprën e këtij shkrimtari janë të fazës së hershme të shqipës dhe si të tilla në këtë punim ato kanë mbetur jashtë interpretimit etimologjik. Kjo bëhet për faktin se huazimet e hershme sot janë pjesë e leksikut aktiv.

Në këtë inventar huazimesh bëjnë pjesë fjalët me origjinë indoevropiane, që shënojnë sende e dukuri të natyrës, kafshë, emra farefisnie, fjalë që shënojnë kohë etj.<sup>4</sup>. Huazimi leksikor më i zakonshëm dhe më i përhapur në gjuhën shqipe është huazimi i fjalëve bashkë me sendet dhe me konceptet e reja. Kur fjalët e huazuara nuk hyjnë me sendet e konceptet e reja, po bashkëpërdoren me fjalët e vendit, kemi huazime gjuhësore<sup>5</sup>. Shumë nga fjalët e huazuara prej gjuhëve të tjera, sipas teorisë së gjuhëve në kontakt, konsideron huazime kulturore. Ato "*depërtojnë*" lehtë në gjuhët marrëse dhe si të tilla pranohen si pjesë aktive e fjalësit të tyre. Jani Thomaj këtë shtresim huazimesh e kualifikon si historiko-kulturor<sup>6</sup>. Fjalët e kësaj origjine përdoren dendur në gjuhën e veprës së Koliqit. Shumë prej tyre autori i përdor edhe për qëllime stili dhe për ndërtim tekstesh narrative.

Ernest Koliqi me krijimtarinë e vet artistike bën thyerje të klisheve të krijuara të kohës së Rilindjes Kombëtare. Qënë vetë temat e zgjedhura, motivet dhe rrëfimi tjetër nga ai i rilindësve që këtë autor e radhitën më pas në nismëtarin e prozës moderne shqipe. I njëjtë del nismëtar për thyerje klisesh edhe në planin gjuhësor. Në këtë aspekt Ernest Koliqi nuk ecën rrugës së bashkëkohësve të vet, si: **P. N. Luarasi**, **P. K. Negovani**, të cilët u hodhën në purizëm të tepruar dhe, në anën tjetër, nuk e rëndoi ligjërimin e tij të shkruar si **Fan S. Noli** dhe **Ali Asllani**<sup>7</sup>.

Në gjuhën e veprës së këtij autori përdoren fjalë të huazuara nga gjuhë të ndryshme. Sipas origjinës këto huazime i kemi klasifikuar në grupe të veçanta, si: **huazime greke, neolatine, sllave dhe orientale**. Këto të fundit zënë vendin kryesor në veprën e tij, posaçërisht në veprat e botuara në periudhën e parë të krijimtarisë së tij. Ato përdoren si burim i pashtershëm përftesash stilistike. Mirëpo, në veprat e periudhës së fundit të krijimtarisë bie dukshëm denduria e përdorimit të këtij shtresimi leksikor. Tashti hetohet një përdorim paksa më i madh i neolatinizmave.

---

<sup>3</sup>Lloshi, ibid. 111.

<sup>4</sup>Thomaj, 1999: 228.

<sup>5</sup>Thomaj, ibid.:228.

<sup>6</sup>Thomaj, ibid.:220

<sup>7</sup>Gjoca, 2001:68.

## 2 Greqizmat

Greqizmat paraqesin nënklasë në vete në kuadër të huazimeve në gjuhën shqipe. Edhe pse shqipja ishte dhe është në kontakt të drejtpërdrejtë me këtë gjuhë, huazimet prej saj janë të pakta. Shumica i takojnë shtresës së vjetër të huazimeve leksikore, gjurmët e të cilave në shqipe datojnë shekuj para epokës sonë <sup>8</sup>. Hyrja e tyre në shqipe është rezultat i fqinjësisë së përhershme me popullin grek.

Huazimet e hershme nga gjuha greke u përkasin fushave të ndryshme shoqërore, ndërsa huazimet bizantine dhe ato të kohës më të re janë pjesë e leksikut që shënojnë gjësede dhe realitete të jetës shoqërore, të artit e shkencës. Shumë nga greqizmat, duke u zëvendësuar me fjalë përkatëse shqipe, siç thotë Thomaj, kanë mbetur në të folme anësore si krahinorizma <sup>9</sup>. Në gjuhën e veprës së Koliqit kjo nënklasë huazimesh është e vogël. Greqizmat në veprën e tij kualifikohen si fjalë të shqipes. Shumica prej tyre janë pjesë aktive e fjalësit të shqipes standarde.

Nga ana tjetër, ky shtresim leksikor, në diskursin ligjërimit të tij, nuk bart ngjyrimet e as vlera të theksuara artistike. Greqizmat dalin si pjesë e leksikut asnjans si në gjithë shqipen. Në pak raste shërbejnë për të përshkruar situata, personazhe dhe vende të caktuara ku zhvillohet ngjarja e akëcilës vepër të hulumtuar. Vështruar në rrafshin përdorues ky shtresim leksikor del më shpesh në ligjëratë se në rrëfim. Në këtë prizëm mund të thuhet greqizmat më shpesh dalin në vetën e parë, e fare pak në të tretën. P.sh. ... *grumbullue pa kurrnji kriter estetik...* ...*nuk gzone sympathin e qytetit.* <sup>10</sup>

Greqizmat: *stetik* dhe *sympathin* janë fjalë që nyjëtohen nga veta e parë, e personifikuar këtu me Hulush Vilzën. Përmes tyre Koliqi portretizon tregtarin shkodran Gaspër Traçaçi, i cili më shumë kishte merakun për shitjen e flamujve se hallin për fatin e atdheut.

Kështu, duke u përdorur ndonjëherë sado pak për nuanca semantike, veta e parë u shkon shtati atyre për përftesa të këtij lloji. Në këtë funksion janë përdorimet e fjalëve: *fyzikë* <sup>11</sup>, *rythmi SH* <sup>12</sup>, *olimpiciteti* <sup>13</sup>, *stigmatizoj* <sup>14</sup>, *mizantrop* <sup>15</sup>, *synthezë* <sup>16</sup>, *ethnikë* <sup>17</sup> etj.

Këto huazime mund të kualifikohen si leksema të veçuara, prandaj shumica prej tyre në veprat letrare të këtij autori ruajnë trajtën shkrimore të gjuhës dhënëse ose të paktën ndonjë veçori fonetike të trajtës burimore. Kjo dëshmohet më së miri me ruajtjen e fonemës /y/ në të gjitha pozicionet e fjalës. Ruajtja e saj i përgjigjet fjalës rrënjë të gjuhës dhënëse, greqishtes.

---

<sup>8</sup>Thomaj, *ibid.*: 231.

<sup>9</sup>Thomaj, *ibid.*:231.

<sup>10</sup>Novela:T F, f. 169.

<sup>11</sup>SH B M, f. 97.

<sup>12</sup>B M, f. 333.

<sup>13</sup>H M, f. 64.

<sup>14</sup>H M, f. 24.

<sup>15</sup>SH B M f. 45.

<sup>16</sup>SH B M, f. 132.

<sup>17</sup>SH B M 132.

### 3 Sllavizmat

Sllavizmat në gjuhën shqipe kanë hyrë gjatë kohës së mesjetës. Shumë prej tyre janë bërë pronë e shqipes dhe sot janë pjesë aktive e fjalësit të saj. Fjalë të kësaj periudhe takohen edhe në gjuhën e veprës së Koliqit. Duke ditur se tashmë ato janë pjesë e leksikut të shqipes, kemi konsideruar se nuk paraqesin ndonjë interes studimi. Ne do të përmendim vetëm disa nga fjalët që autori i përdor për efekte stilistike.

*Huazimet nga kjo gjuhë, sipas Thomaj, kanë përfunduar në shekullin e XV-të. Më pas ndikimi i sllavishtes u ndërpre pothuajse tërësisht*<sup>18</sup>.

Studimet për ndikimet sllave, posaçërisht të serbishtes në shqipe, flasin për ndikime jo vetëm leksikore, por edhe në rrafshet e tjera gjuhësore, posaçërisht në ndërtime sintaksore edhe pas shekullit të XV-të. Këto ndikime qenë më të mëdha në viset shqiptare që kishin mbetur pjesë e ish-Jugosllavisë.

Sipas Xhevat Lloshit, disa prej këtyre huazimeve ndihen si krahinorizma të zonave kufitare<sup>19</sup>. Ky konstatim nuk duket aq i qëndrueshëm po të shihen studimet që janë bërë për ndikimin e gjuhëve sllave në idiomat dialektore të viseve jashtë kufijve administrativë të Shqipërisë. Shumë sllavizma, ndonëse nuk janë në FGJSSH, edhe sot janë aktive dhe "*presioni pranues*" nuk ka mbaruar as sot e kësaj dite.

Pavarësisht numrit të madh të sllavizmave në shqipe ky shtresim leksikor në gjuhën e veprës së këtij autori del në masë mjaft të reduktuar. Kjo për faktin se fjalët e kësaj origjine, të cilat u takojnë periudhave të hershme, ishin stabilizuar në fjalorin e shqipes, ndërsa fjalët e reja, që kishin hyrë më vonë, lëkundeshin midis përdorimit letrar dhe atij dialektor. E, Koliqi, ndiqte rrugën e konvergencës gjuhësore, prandaj mendoj se ishte i kursyer në përdorimin e tyre. Sllavizmat "*e paintegruara*" në kohën e tij më tepër bënin trysni në gegërishte, pasi ekzistonte kontakti i drejtpërdrejtë. Kështu ata nuk kishin ndonjë status të qëndrueshëm as në gegërishte në kohën kur Koliqi botonte veprat e tija me gjuhën e përzgjedhur edhe ishtitucionalisht si kod për standardin e shqipes mbi bazën e elbasanishtes.

Prandaj, leksemat sllave në veprat e Koliqit mund të konsiderohen si krahinorizma, të ardhura nga kontakti gjuhësor prej gjuhës me prestigj. Përdorimin e tyre Koliqi e përfill më shumë për efekte stilistike, posaçërisht në ligjërimin rrëfimtari. Sado të përdorura pak, megjithatë këto leksema i japin ngjyrim stilistik këtij ligjërimi. Foljet bërthamë të fjalive drejtuese dalin në kohët e rrëfimit: **në të kryerën e thjeshtë, të pakryerën dhe në kohën më se të kryer.**

Më poshtë po japim disa raste kur autori përdor këto leksema për efekte të tilla. **Rasti I:** Pleqt e dy palve u ndeshën në ditë të shënueme në vend ku ish dá oroku. Novela: (H M, f. 79) Okolle perdeve kishin rrjeshtue flaniktha të madhej .... Romani: (Sh B M, f. 87) **Rasti II:** Mungonte një gjysmë ore m'u bâ koha e orokut caktua prej Djanës. Romani: (SH B M, f. 87) **Rasti III:** Kot e brigonte veten. Romani: (SH B M, f. 87)

Fjalët e këtij shtresimi leksikor, siç u tha edhe më lart, ndonëse të pakta numerikisht,

---

<sup>18</sup>Thomaj, ibid.:233.

<sup>19</sup>Lloshi, ibid.:116.

në gjuhën e veprës së Koliqit përdoren për efekte artistike. Shembujt tregojnë se këto stilema marrin vlera shprehëse për përshkrime situatash, rrethanash, si dhe karakterizim personazhesh. Ndonjëherë leksemat e tilla autori i përdor edhe për krijimin e vlerave sinonimike (shih rastin II).

## 4 Orientalizmat

Në shtresimin leksikor të orientalizmave të gjuhës së veprës së Ernest Koliqit janë të përfshira leksema nga gjuhë të ndryshme orientale. Ndonëse ka shumë prej tyre që në shqipe kanë hyrë edhe më ndihmën e gjuhës ndërmjetësuese, në rastin tonë nga turqishtes, në këtë punim të gjitha janë trajtuar së bashku. Kjo gjë është bërë për faktin se pavarësisht prejardhjes së tyre, duke u futur në gjuhën shqipe, në rrugë të tërthortë ose nga kontakti i drejtpërdrejtë që shqipja kishte me turqishten, të njëjtat reflektojnë më shumë ngjashmëri me fjalët e gjuhës transmetuese, turqishtes, se të gjuhëve arabe dhe të persishtes. Ngjashmëritë janë fonetike edhe morfologjike.

Pushtimi osman në Shqipëri zgjati pesë shekuj, deri më 1912. Gjurmët e këtij pushtimi mbetën edhe në gjuhë <sup>20</sup>. Kjo shtresë leksikore ngërthen në vete fjalë që lidhen me fusha të ndryshme shoqërore. Ato janë fjalë të urbanizmit, kuzhinës, administratës, madje edhe të artit. Por efektet gjuhësore të këtyre fjalëve në ndonjë rast janë të mrekullueshme. Turqit ishin në rolin e një katalizatori të nxitjes së kontakteve gjuhësore, sidomos në fjalorin jobazik të gjuhëve të Ballkanit <sup>21</sup>. Prandaj, këto gjuhë kanë aq shumë orientizma që rrinë në periferinë e sistemeve leksikore të tyre.

Një dallim të qartë midis fjalëve të kësaj origjine e bën Lloshi. Sipas tij, Perandoria Osmane në administratën e vet një periudhë të gjatë ka përdorur osmanishten, jo turqishten që njohim sot, kurse feja ka përdorur arabishten e veçantë të Kuranit <sup>22</sup>.

Hulumtimi i leksikor i veprës së Koliqit tregon se turqizmat kanë përdorim shumë më të dendur se arabizmat dhe persizmat. Rreth 80 për qind e fjalëve të huaja në krijimtarinë artistike të këtij autori dalin me këtë prejardhje. Denduria e përmendur mund të shpjegohet me faktin se Koliqi nuk kishte ndjekur rrugën e rilindësve, të cilët mënjanonin me çdo kusht fjalët e kësaj etimologjie. Madje, ai u dallohet edhe nga shkrimtarë të kohës së vet. Studimi ynë tregon se Koliqi nuk ndoqi rrugën e purizmit ekstrem, por as nuk e teproi me përdorimin e fjalëve joshqipe. Në shkrimin "*Ndikime orientale në letërsinë shqiptare*" vetë Koliqi sqaron qëndrimin e tij ndaj orientalizmave. Duke folur për purizmin e tepruar të rilindësve ai thotë:

*"Madje, kryesisht kundra skajeve turke pati tepri aq fanatike neverie sa me shkaktue një kundërveprim plot mend të vetë Fishtës, i cili në një satirë të veten, tue i dhanë gjallni një përshkrimi të ambjentit e të zakoneve me një fjalë shumë të përshtatshme turke, shtoi ndër kllapa vargun në zâ: Ka'j fjal' turçe bân lazem!"*

<sup>20</sup>Thomaj, ibid.:233.

<sup>21</sup>Thomason, 2001:15.

<sup>22</sup>Lloshi, ibid.:116.

Ky qëndrim arsyeton gjithë përdorimin e fjalëve të origjinës orientale në veprën e tij. Ai e kishte të qartë se eliminimi i tërësishëm i huazimeve nga gjuha shqipe, posaçërisht nga letërsia e shkruar, ishte i dëmshëm pasi ato konsiderohen mjete të rëndësishme gjuhësore për ndërtimin e tekstit letrar dhe të stilit. Nga ana tjetër, duket se autori kishte hetuar rëndësinë e përdorimit të këtij shtresimi leksikor edhe si mjete më derivacion të pëlleshëm shprehësie. Funkzioni shprehës evokues i turqizimeve mundëson rikrijimin e mjedisit dhe krijimin e situatave të ndryshme, dhe dëshmon se edhe elementet e huaja gjuhësore mund të kenë funksion shprehës evokues në shkallë shumë të lartë <sup>24</sup>.

Ndonëse jo gjuhëtar, duket se Koliqi e kishte hetuar shumë mirë se shprehja letrare ngrihet dhe bëhet e kapshme për receptuesin vetëm atëherë kur ajo ndërtohet mbi bazën e traditës gjuhësore, të historisë, të mitologjisë dhe se çdo veprim i transmetuar përmes saj duhet të reflektojë shumëllojshmërinë e realitetit individual dhe kolektiv. Së këndejmi, orientalizmat, si leksema të një gjuhe me prestigj afër 5 shekuj përballë shqipes, shtrihen gjithandej veprës së tij.

Hulumtimi i këtij shtresimi leksikor, në korpusin e përmendur në fillim të këtij punimi, ka pasqyruar të dhënën se orientalizmat janë përdorur më shumë në periudhën e parë të krijimtarisë së tij. Në botimet e mëvonshme Koliqi del më i kujdesshëm. Posaçërisht në dy botimet e fundit, në romanin: "*Shija e bukës së mbrumë*" dhe në "*Pasqyrat e Narçizit*" dalin pak orientalizma, të cilat njëkohësisht kanë edhe frekuencë të vogël përdorimi. Në këto dy vepra vërehet një përdorim paksa më i dendur i fjalëve neolatine, gjë që mund të shpjegohet me qëndrimin tani të përhershëm të autorit në migrim, në Itali.

Fjalët me origjinë orientale autori i këtyre veprave i përdor me vlera të caktuara të evokimit. Prandaj, i vetëdijshëm për gjurmët e pushtimit otoman në të gjitha sferat e jetës, dhe në këtë mes edhe në gjuhën "*organike*", këtë shtresim leksikor autori e përdor më shumë për efekte stilistike. Orientalizmat, më shumë se të gjitha huazimet e tjera ofrojnë këtë mundësi.

Në çdo tip marrëdhëniesh gjuhësore gjithnjë marrin pjesë tre përbërës: "*personi i parë*", ai që flet, "*personi dytë*", me të cilin flitet, dhe "*personi i tretë*", ai për të cilin flitet <sup>25</sup>.

Përdorimi i orientalizmeve në tekstin letrar të Koliqit i përgjigjet shumë mirë këtij konstatimi. Fjalët e kësaj origjine janë pjesë e ligjërit të tri vetave, në numrin njëjës dhe shumës. Në fakt, në rastin e fundit, ato shërbejnë për të përshkruar personin ose dukurinë për të cilën flitet. P.sh...ai ishte prisi shokve ndër qefe e mbreti i ahengejeve qytetare.. Tregimi: "*Te tre lisat*", (H M, f.133) Tue mbajtë uzdajë se nuk do të rrinte shtëpi pa e marrë ka një, i porosita me turra... *Novela*: (T F, f.174) U shitne a s'u shitne flámujt, qëndroi a s'qëndroi Shqipnija, un kam mjaft, shyqyr, me jetue.... *Novela*: (T F, f. 175) -Pse u apin gjith at randsi vetit, xhanem? *Novela*: (T F, f. 185) ...nëpër të gjitha skâjet e dugâjës plot e përplot me denga e me arkë.... *Novela*: (T F, f. 169) Baba em, rahmet pastë, më thotë gjithmonë se nën kalá të Drishtit ka gjâna të kushtueshme

<sup>23</sup>Koliqi, 2003:195.

<sup>24</sup>Islamaj, 2000:153.

<sup>25</sup>Lešic.1971:121.

gropue në dhé. Tregimi: "*Djepi arit*" (P N, f. 284) Unë, me petk e me shapkë "alla marinara"... Tregimi: "*Kroni i Bardhonjavet*" (P N, f. 328) Ajo shtëpi, ajo odë... Tregimi: "*Pasqyra e vjetër shkodrane*" (P N, f. 325) Tash ai ishte i plotsuem më të gjitha shartet qi nevojiteshin... Romani: (SH B M, f. 33) ...i a lëmojshin sedren.... Romani: (SH B M, f. 35)

Pushka e trimit dhe sofa e gjymertit nuk priten! Romani: (SH B M, f. 178)

Shembujt e mësipërm tregojnë se Koliqi ka përdorur orientalizmat si leksema të qëllura edhe për përftesa stilistike. Me ndihmën e tyre autori përshkruan gjendje emocionale (*xhanem, rahmet, sedren*), por edhe vendin e ngjarjes, situatën. Ndërsa, rasti i fundit flet se Koliqi, në gjuhën e veprës së tij, ngërthen pa u hamendur edhe frazeologjizma të krijuara edhe me leksema orientale, kurse një kategori fjalësh, si disa prej shembujve me lartë, i përdor edhe për realizim humori, madje edhe satire.

Siç është thënë edhe një herë orientalizmat në gjuhën e veprës së këtij autori, në fillim të krijimtarisë së tij, kishin përdorim më të dendur. Në botimet e viteve të gjashtëdhjeta, siç është rasti me romanin "*Shija e bukës së mbrume*" dhe me novelën "*Pasqyrat e Narçizit*" fjalët e këtij shtresimi përdoren shumë më pak. Ikja nga përdorimi i këtij shtresimi leksikor, që lidhet me fazën e fundit të krijimtarisë së autorit, mund të ilustruhet me tregimin "*Ujë e pusit*" në "*Pasqyrat e Narçizit*". Hulumtimi ynë tregon se në këtë tregim Koliqi nuk ka përdorur asnjë fjalë më origjinë orientale. Shkaqet këtu duhet kërkuar në një plan krejtësisht tjetër gjuhësor dhe jashtëgjuhësor. Koliqi kishte migruar në Itali dhe sigurisht se rrethanat e reja të jetës, ndërrimi i "**kodit ligjërimit**", si dhe kontakti tashmë i pashkëputur me gjuhën dhe kulturën perëndimore kishin ndikuar në këtë "*transformim*" gjuhësor e stilistik. Prandaj përligjet ikja nga orientalizmat dhe "*përqafimi*" në masë i neolatinizmave, të cilat megjithatë janë më shumë të karakterit shënjuës. Vështruar nga funksioni i përdorimit të orientalizmave mund të thuhet se pos përshkrimit të karaktereve, në veprën e Koliqit ky fjalor kryen edhe funksionin e lokalizimit, madje edhe të identifikimit të përafërt vendit të zhvillimit të fabulave të veprave të tij. Ky shtresim leksikor, që ka ngritjet dhe rëniet e veta në gjuhën e prozës së këtij autori të shumtën e rasteve mbart vlera evokuese. Dhe më shumë se kaq fjalët me origjinë orientale në veprën e Koliqit tejkalojnë qëllimin e shënimit të thjeshtë. Ato gati gjithnjë marrin ngjyrimë shumë të ndërlikuara, duke i dhënë ligjërimit të tij një ngjyrë sa origjinale aq edhe artistike. Prandaj, këtë shtresë leksikore autori qëllimshëm e zgjedh si formë të ligjërimit letrar. Vepra e Koliqit mund të shihet si model i shkëlqyer i individualizimit të personazheve dhe i ngjyresës gjuhësore të mjediseve që përshkruhen në prozën e tij <sup>26</sup>.

---

<sup>26</sup>Shkurtaj, 2006:90.

## 5 Neolatinizmat

Shtresa leksikore nga gjuhët neolatine në gjuhën e veprës së Ernest Koliqit reflekton fjalë të vjetra të latinishtes, si dhe fjalë më të vona nga italishtja dhe frëngjishtja. Këto fjalë kanë një status tjetër nga orientalizmat dhe sllavizmat. Huazimet kryesore nga latinishtja u përkasin shekujve të parë të epokës sonë. Pushtimi romak në Shqipëri zgjati 500 vjet

<sup>27</sup>.

Fjalët me prejardhje latine në gjuhën e veprës së këtij autori nuk paraqesin ndonjë interes studimi. Përdorimi i tyre është më tepër i karakterit shënjuës dhe korrespondon me terminologjinë gjuhësore që i mungonte shqipes së kohës së tij. Në këtë mes autori ka përdorur një shtresim fjalësh jo aq të pasur dhe gati gjithnjë në këtë funksion. Këto huazime në shqipe kanë ardhur sidomos me rrugë librore, të lidhura me sfera të specializuara të teknikës, shkencës, prodhimit e kulturës. Përgjithësisht fjalët neolatine kanë vëllim kuptimor më të ngushtë, përmbajtje më të përpiktë dhe polisemi më të përcaktuar

<sup>28</sup>. Kështu dalin edhe në gjuhën e veprës së Koliqit.

Meqë shumica e fjalëve të këtij shtresimi leksikor shënojnë koncepte që nuk kanë ekuivalente në gjuhën marrëse, si të tilla konsiderohen pasuri leksikore e ngulitur në shqipe. Ato zakonisht janë pjesë e leksikut profesional dhe terminologjik.

Leksemat nga italishtja, si: *batare, marinar* etj., që takohen në gjuhën e këtij autori, janë fjalë që gjenden edhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe <sup>29</sup>. Njëjtë si edhe te autorët e tjerë këto fjalë nuk kanë ndonjë polisemi të caktuar dhe as ngjyrim stilistik. Interesante del e dhëna se Koliqi, ndonëse ishte i shkolluar në Itali dhe pjesën e fundit të jetës së vet e kishte kaluar në këtë vend, në diskursin e tij shkrimor përdor fare pak leksema të origjinës neolatine. Kujtoj se përkushtimi i tij për një gjuhë të përbashkët, nga njëra anë dhe mungesa e polisemisë dhe e ngjyrimit stilistik të këtij fjalësi, nga ana tjetër, janë faktorët kryesorë për këtë qëndrim të autorit ndaj këtij shtresimi leksikor.

## 6 Përfundime

Hulumtimi i gjuhës së veprës së Ernest Koliqit në planin gjuhësor, më saktë identifikimi i fjalësit të huaj dhe përdorimi i tij në disa prej veprave në prozë, qet në pah prirjen e këtij autori për shmangie të vetëdijshme nga tradita e krijuar prej pararendësve e vet rilindës, të cilët me çdo kusht insistonin nënjanimin e fjalëve të huaja nga gjuha shqipe, posaçërisht të atyre me origjinë orientale, duke kaluar kështu në purizëm ekstrem. Studimet e pakta për këtë autor në planin letrar kanë argumentuar edhe në thyerjen e klisheve në fushë të letrave shqipe. Koliqi, me krijimtarinë e vet artistike shumë kohë pas epokës së tij, e cila për disa dhjetëvjetësha ishte ndaluar, duke e bërë atë njërin ndër shkrimtarët më të anatëmuar, tashmë është identifikuar si nismëtar i prozës moderne shqipe.

Edhe në planin gjuhësor ky autor dallon nga pararendësit e tij. Është hulumtimi i

---

<sup>27</sup>Thomaj, *ibid.*:232.

<sup>28</sup>Lloshi, *ibid.*:115.

<sup>29</sup>Shih: FGJSSH, 1981:117- 1058.

leksikut të huaj në veprën e tij një ndër argumentet kryesore se Koliqi vetëdijshtëm kishte tejkaluar pararendësit e vet, si: **P. N. Luarasi**, **P. K. Negovani** etj., të cilët ishin hedhur në purizëm të tepruar dhe, në anën tjetër, po ky hulumtim jep për të kuptuar se megjithatë ky shkrimtar kishte arritur të mos e rëndonte ligjërimin e tij të shkruar me këtë shtresim leksikor, siç kishin bërë **F. Noli** dhe **A. Asllani**. Hulumtimi ynë e nxjerr Koliqin të vëmendshëm në përdorimin e leksikut të huaj. Veprat e hulumtuara në këtë plan nxjerrin në dritë të vërtetën se shkrimtari i përmasave të mëdha, pa ndonjë përgatitje gjuhësore, kishte respekt për gjuhën dhe në këtë qëndrim gjithë leksiku i huaj më tepër ishte përdorur për përftesa stilistike.

Ndonëse nuk ishte gjuhëtar, Koliqi mund të identifikohet pa hamendje si njohës shumë i mirë i gjuhës shqipe. Në veprën e tij letrare, pos përdorimit të fjalëve të shqipes së normuar të kohës së tij dhe të dialektizmave, të cilat shpesh i rifunksionalizon për efekte arti, përdor edhe shumë shtresime leksikore me origjinë joshqipe. Disa prej tyre marrin edhe karakter evokues për tipizim personazhesh e përshkrim situatash. Në këtë mes duhet përmendur posaçërisht orientalizmat, të cilat edhe ashtu dihet se nga të gjitha huazimet dallohen për vlera shprehëse. Mbi 80 për qind e fjalëve të huaja të përdorura nga ky autor, në veprat e hulumtuara, dalin të kësaj origjine. Në përdorimin e leksikut të huaj në prozën e Ernest Koliqit vërehen lëvizje. Derisa në novelat e para: "Hija e maleve" dhe "Tregtar famujsh" përdorimi i orientalizmave është i dendur kjo gjë nuk ndodh në botimet e mëvonshme. Posaçërisht novela "Pasqyrat e Narçizit" dhe romani i tij i vetëm "Shija e bukës së mbrumë" dallojnë për përdorim të vogël fjalësh orientale. Koliqi tashmë po bënte jetë emigranti në Itali, prandaj përdorimi i fjalëve të huaja, në këtë mes i orientalizmave, tkurret dukshëm.

Fjalët me origjinë orientale dhe më pak sllave Koliqi i përdor për qëllime stilistike. Narracioni ndërtohet shpesh mbi bazën e këtyre dy shtresimeve, të cilët me mjaft shkathtësi gjuhësore autori u jep polisemi, karakter evokues dhe bashkë me këto edhe përftesa stilistike. Fjalësi i huaj, në radhë të parë orientalizmat, nuk e dëmtojnë diskursin ligjërimor të këtij shkrimtari. Përkundrazi. Si konstatim do të thoshim se gjuha e këtij shkrimtari nuk qëndronte larg standardit të kohës, elbaskanishtes. Pavarësisht përdorimit të fjalëve me prejardhje të huaj ligjërimi i tij i shkruar mund të konsiderohet ndihmesë për bashkimin e varieteteve gjuhësore që i rezistonin "standardit".

## REFERENCAT

1. **Filipoviç, Rudolf**. (1986) *Teorija jezika u kontaktu*, školska knjiga, Zagreb.
2. **Fjalor i gjuhës së sotme shqipe**(1981). *Rilindja*, Prishtinë.
3. **Gjocaj, Gjocaj**. (2001), *Gjuha e Luigj Gurakuqit dhe konceptet e tij gjuhësore e stilistike*, XX, Prishtinë.
4. **Islamaj, Shefkije**. (2000), *Gjuha e Jakov Xoxës*, IAP, Prishtinë
5. **Koliqi, Ernest**. (2003), *Ndikimet orientale në letërsinë shqiptare*, në Vepra IV, Prishtinë.
6. **Lešić, Zdenko**. (1971), *Jezik i književno djelo*, Zavod za izdavanje udžbenika, Sarajevo.
7. **Lloshi, Xhevat**. (1999), *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë.
8. **Shkurtaç**,

**Gjovalin.** (2006), *Kundrime gjuhësore*, Pegi, Tiranë. 9. **Thomaj, Jani.** (1999), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë. 10. **Thomason G,** Sarah. (2001), *Language Contact*, Edinburgh University Press